

VENDIM
Nr.940, datë 17.11.2010

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASIT AVRI LIÇANJI SHINI, NË TURQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, në artikullin “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Avri Liçanji Shini, në Turqi.

2. Efektet financiare për mbulimin e këtyre shpenzimeve të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesat të bëhen kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha